

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

27.01.2025
Ora, 13:47

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|---------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | E. Meta, A. Agolli. |

Parti Politike: S’ka prezent.

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike sot, sikur nuk kemi. Kemi dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një projektvendim, “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend”. Para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektvendimi, pyes kolegët, nëse kanë çështje jashtë rendit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

të ditës për të trajtuar, në mënyrë që të mbajmë rradhën e folësve. Kolegë, kemi diçka? Nuk ka! Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Në mënyrë të përmbledhur, Zoti Meta, një përmbledhje, një pasqyrë të projektvendimit.

Z. E. Meta: Mirëdita të nderuar! Referuar nenit 20 të Kodi Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së, përfshirë udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Udhëzuesi i punës ka për qëllim të ofrojë udhëzime të qarta dhe të strukturuar për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor në lidhje me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve për Kuvend duke njesuar praktiken zgjedhore. Ky udhëzues pune ju vjen në ndihmë administratës zgjedhore, partive politike dhe aktorëve të tjerë për veprimtarinë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor. Udhëzues synon të sigurojë që të gjitha procedurat dhe detyrat të kryhen në përputhje me ligjin dhe në mënyrë efikase, duke plotësuar kompetencat e Komisionit Rregullator për njehsimin dhe përmirësimin e praktikave zgjedhore. Projektvendimi përfshin udhëzime të detajuara mbi përbërjen e KZAZ, kushtet për emërimin, lirimin dhe shkarkimin e anëtarëve të KZAZ, mbledhjet dhe vendimmarrjen e saj, si dhe menaxhimin e vakancave të krijuara. Gjithashtu, projektvendimi përfshin detyra funksionale të KZAZ si krijimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit, procedurat për caktimin e anëtarëve të KQV dhe plotësimin e vakancave, akreditimin e vëzhguesve, organizimin e VNV, dhe shpërndarjen e materialeve të votimit. Për të arritur qëllimin e tij, udhëzuesi i punës është strukturuar në mënyrë të tillë që të jetë i qartë dhe i lehtë për t'u kuptuar nga anëtarët e KZAZ-ve. Ai përmban informacione të detajuara dhe të organizuara në mënyrë logjike, duke përfshirë shembuj praktikë dhe udhëzime hap pas hapi. Në fund të udhëzuesit janë cituar në mënyrë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

përmbledhur detyrat e KZAZ dhe një listim i akteve të KQZ që lidhen me veprimtarinë e KZAZ. Ky material ndihmës përcakton veprimtarinë e KZAZ deri në marrjen në dorëzim të materialeve të votimit nga KQV, ndërsa detyrat e KZAZ lidhur me procesin e numërimit të votave dhe menaxhimin e rezultateve të zgjedhjeve do të trajtohen në udhëzuesin e punës për GNV. Në udhëzuesin e punës ka informacion mbi përbërjen e KZAZ, kushtet për emërimin, lirimin apo shkarkimin e anëtarit të KZAZ, mbledhjet e saj, vendimarrja në kushte të zakonshme dhe në kushte e vakancave të krijuara në KZAZ. Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend”.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Meta! Fillojmë shqyrtimin e projektvendimit, në parim. Kolegë kemi diçka? Nuk kemi! Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Znj. H. Vukaj: Një konstatim të vogël. Kolegu Çakaj, në mbledhjen e kaluar, por dhe në çdo mbledhje, ka ngritur çështjen e papërbushjes së anës formale të relacionit. Relacioni duhet siç e dini me firmën e Komisionerit. Kjo nuk duhet të ndodhë më, sepse për ndryshe do të marrim masa që mbledhjet nuk do të zhvillohen. Ana formale, në dijeninë tuaj, nëse keni formimin jurist, është po aq e rëndësishme sa ajo substanciale, apo proceduriale. Në rregull!?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

Znj. I. Nano: Fillojmë atëherë, me shqyrtimin e projektvendimit. Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “gh”, nenit 115 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi: Pika 1. Miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Atëherë, materiali është voluminoz, megjithatë unë do të kaloj vetëm në trajtimin e përgjithshëm. Pra, cilat janë çështjet në materialin..., pra thelbin e materialit, ajo ç’ka miratojmë është udhëzuesi i punës. Kemi:

- Organet e administrimit të zgjedhjeve;
- Rregullat e etikës;
- Parimet mbi të cilat mbështetet KZAZ ;
- Përbërja e KZAZ;
- Emërimi i anëtarit dhe sekretarit të KZAZ;
- Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarit të KZAZ;
- Vakancat në KZAZ;
- Mbledhjet e KZAZ;
- Vendimet e KZAZ;
- Organizimi i KZAZ;
- Detyra të KZAZ për krijimin dhe funksionimin e qendrës së votimit;
- Procedura që KZAZ-ja ndjek për të emëruar anëtarin e shtatë;
- Detyra të KZAZ për akreditimin e vëzhguesve;
- Verifikimi i dokumentacionit, ku përfshihet dhe verifikimi i dokumentacionit për vëzhguesit dhe vendimmarrja e KZAZ-së si dhe të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve;
- Vëzhguesit e akredituar nga KQZ;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

- Mediat e akredituara;
- Detyra të KZAZ për organizimin e VNV;
- Caktimi i Grupit të Numërimit të Votave;
- Skema organizative e funksionimit të VNV-së që lidhet me vendosjen e tavolinave të numërimit dhe grupet përkatëse të numërimit;
- Detyra të KZAZ për shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit dhe pastaj kthimi i materialeve që KZAZ merr nga KQZ për çdo qendër votimi;
- Veprimtaria e KZAZ në ditën e zgjedhjeve;
- Procedura e marrjes në dorëzim të kutive dhe materialeve të votimit nga KQV-të;
- Një tabelë me detyra të përmbledhura të KZAZ-së, sipas atyre që sapo lexova dhe që janë të sqaruara në manual. Atëherë, kolegë ky është teksti i manualit të cilin do të duhet ta votojmë si pikë 1 të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!


Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë...

Nuk kemi zonja Vukaj, atë që ju hera herës..., “ngarkimin me detyra të...”.

Znj. H. Vukaj: Pikërisht, na bën përshtypje të gjithëve, sepse është një gjë që nuk përmbushet dhe nuk e kuptoj arsyen.

Znj. I. Nano: Pra, si pikë e dytë, para se të shkojmë te “Hyrja në Fuqi”, kemi “Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KZAZ-të dhe institucionet e tjera, për zbatimin e këtij vendimi”. Pra, siç e kemi në aktet e tjera.

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

Atëherë, pikën 1 e votuam, pikë e dytë është kjo që sapo diskutuam me zonjën Vukaj. Administrata, do t'ju lutesha pas votimit tonë ta reflektojë.

Kush është dakord me pikën 2, për ngarkimin me detyra?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Sapo miratuam udhëzuesin e punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend". Pas miratimit do t'ju lutesha për një zbardhje

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.01.2025*

të shpejtë, që ne ta nënshkruajmë, sepse padyshim ju do të filloni procesin e prodhimit dhe shpërndarjen në KZAZ të këtij manuali. Çështje jashtë rendit të ditës...

Znj. H. Vukaj: Nuk kërkuam fjalën për çështje jashtë rendit të ditës, por thjesht në meritë të rëndësisë që ka procesi i regjistrimit, unë sërish do t'i adresohem Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, meqenëse ai nuk zgjedh të jetë prezent. Nëse ka çështje të cilat kanë të bëjnë me vendime, aktet tona të cilat impaktojnë, apo nevojitet të ndryshohen, përmirësohen, apo dhe të shtohen me rregulla të reja, jam e gatshme. Besoj se dhe ju kolegë, jeni të gatshëm për ndërhyrje në këto akte menjëherë. Në këtë kuadër, i bëj thirrje të gjithë emigrantëve, të regjistrohen, të regjistrohen, të regjistrohen, sepse ky proces është shumë i rëndësishëm për ta dhe për ne. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Vukaj! Nuk kemi çështje të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

